

VENDIM
Nr. 253, datë 9.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 182, DATË 25.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E RREGULLUESIT KRYESOR (*LEAD MANAGER*) DHE/OSE HUADHËNËSIT PËR REALIZIMIN E HUAMARRJES ME INSTRUMENTE FINANCIARE NË TREGUN E HUAJ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të nenit 7, shkronja “ç”, dhe të paragrafit të dytë, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 182, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikat 2, 7 e 8, fjalët “... struktura përgjegjëse për huamarrjen...”, zëvendësohen me “... struktura përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat ...”;

b) Kudo ku referohet emërtesa “Ministria e Financave”, zëvendësohet me “ministria përgjegjëse për financat”, si dhe kudo tjetër, përveç shkronjës “a” të këtij vendimi, ku referohet “struktura përgjegjëse për huamarrjen”, zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për borxhin publik”;

c) Në pikën 3, shkronja “c”, në fund të fjalisë shtohet fjala “të ndryshuar”;

ç) Fjala e parë e pikës 6 zëvendësohet me fjalinë me këtë përmbajtje:

“Pas dorëzimit zyrtar në protokollin e ministrisë përgjegjëse për financat të propozimeve nga institucionet e interesuara, struktura përgjegjëse për borxhin publik në ministrinë përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me struktura të tjera të kësaj ministrie, fillon vlerësimin e tyre.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama